



LABORATOR BIO-DIAGNOSTIK VETERINAR

Adresa: Rruga Haxhi Hysen Dalliu,
Pallati nr. 91, shkalla 1/3 (pranë Prokurorisë së Tiranës)

Tel: +355 42 46 92 07
e-mail: infobiov@gmail.com

Testi i Barsmërisë në gjedhë

Zbulimi sa më i hershëm i barsmërisë në lopët e qumshtit është një pikë e rëndësishme sot në menaxhimin e programeve të riprodhimit. Veterinerët dhe fermerët e përdorin këtë metodë për të zbuluar sa më herët lopët jobarsa në mënyrë që të nxisin riprodhimit dhe të shkurtojnë intervalet ndërmjet pjelljeve. Kështu maksimalizohet prodhimi i qumshtit dhe të ardhurat e fermës.

Tradicionalisht, lopët vbarsa zbulohen nëpërmjet palpimit rektal, që në shumë raste mund të shkaktojë dëme në lopët barsa. Kontrolli serologjik është një metodë, përdorimi i së cilës mundëson zbulimin e shtatzanisë që ditën e 28-të dhe kështu bëhet një mjet mjaft i rëndësishëm në dorën e veterinerëve dhe fermerëve në zbulimin e hershëm të barsmërisë. Ky test mund të përdoret që ditën 60-të pas shkëputjes.

Rotavirus, Coronavirus dhe E.coli

Diareja është shkak kryesor i ngordhjes në viça nën një muaj. Gastroenteriti në viça shpesh shkaktohet prej shumë faktorëve. Mund të jetë pasojë e infeksioneve virusale (Coronavirus dhe Rotavirus), infeksioneve bakteriale (Colibacillus enterotoksikogen, Salmonella) ose infeksioneve nga protozoarët (Cryptosporidium parvum). Diagnoza e rasteve të diareisë në viça duhet detyrimisht të përcaktohet nga testet laboratorike, meqënëse është e pamundur të identifikohet shkaktari mbështetur vetëm në shenjat klinike. Testi që propozohet kryen diagnozën diferenciale ndërmjet këtyre 3 shaktarëve; Rotavirus, Coronavirus dhe E.coli, në kampionet nga feçet. Kjo është një metodë mjaft e besueshme dhe adekuatë edhe në një numër të madh kampionesh.

Paratuberkulozi në gjedhë (Sëmundja e John-it)

Paratuberkulozi (Sëmundja e John-it) haset në gjedhë dhe të imta në formën e një enteritis kronik, shenja kryesore e të cilit është diareja e zgjatur dhe humbja e peshës trupore. Zakonisht kafshët infektohen gjatë vitit të parë, nëpërmjet ngrënies së ushqimit të kontaminuar me feçet e kafshëve të infektuara. Sëmundja mund të vazhdojë nga disa muaj në disa vjet dhe në fund përfundon me ngordhjen e kafshës. Me anë të testit ELISA për verifikimin e Paratuberkulozit, bëhet i mundur diagnostikimi i sëmundjes në kampionet e gjakut ose qumshtit nga lopë apo dhen/dhi të infektuara.

Rinotrakeiti Infektiv i gjedhit (IBR)

Rinotrakeiti infektiv i gjedhit (IBR) shkaktohet nga një herpesvirus-1 (BHV-1) dhe është një nga sëmundjet qëshkakton më shumë dëme ekonomike në gjedhë. Njihen 5 sindroma të sëmundjes. Sindromi respirator, sindromi Ikonjuktivitit, (syri i kuq), infeksionet gjenitale, abortet dhe infeksionet e trurit apo encefaliti. Në viça infeksioni mundtë marrë një formë të gjeneralizuar. BHV-1 është cilësuar si patogjeni kryesor, shkaktar i sindromit respirator të quajtur “ethja e udhëtimit”. IBR zakonisht prek 20 deri 30% ose më shumë të kafshëve të ekspozuara. Megjithesemortaliteti nuk është shumë i lartë, infeksioni le shteg infeksioneve bakteriale sekundare

çka mund të çojë në pneumoni shumë të rëndë deri në ngordhje. Ndërsa në viça dëmi më i madh i shkaktuar është rënia në peshënë lopë vihet re një rënie eprodhimit të qumshtit, abortet he lindje e viçave të dobët të pashëndetshëm. Mortaliteti vjen si rezultat i infeksioneve bakteriale. Për diagnozën e sëmundjes përdoren mjaft teste diagnostike. Por metod më specifike dhe më sensitive është PCR (polymerase chain reaction). Me anë të kësaj metode është mundur të zbulohen sasi shumë të vogla të virusit në sekrecionet e hundës apo në organe.

Diareja Virale e Gjedhit (BVD)

Diareja Virale e Gjedhit (BVD), që shkakton infektion të mukozave në gjedhë, sjell humbje të mëdha ekonomike në fermat e gjedhit. Në mjaft vende të botës kanë filluar programet për çrrënjosjen e kësaj sëmundje, ku futen masat e kujdesit për kafshët e sëmura. Sa më shpejt të zbulohet sëmundja dhe sa më isaktë të jetë rezultati i diagnozës aq më të ulëta do të jenë dëmet. Infeksioni që në mitër, në ditën 60 deri 120 të barsmërisë çon në lindjen e viçave të infektuar të përhershëm. Këta janë seronegative gjatë gjithë jetës, por e mbajnë virusin në organizmin e tyre. Kërkohej një diagnostikim sa më shpejt i kafshëve të infektuara. Përdorimi i RT-PCR lejon zbulimin e sasive mjaft të vogla të virusit të BVD në gjakun apo organet e kafshëve të infektuara, madje edhe në çka më të vegjël se 3 muaj.

Paratuberkulozi në gjedhë

Mycobacterium paratuberculosis (MAP) është shkaktar i sëmundjes së Johnit ose ndryshe Paratuberkulozit. Kjo është një nga sëmundjet më të rëndësishme në aspektin ekonomik, kryesisht në gjedhë dhe të imta. Sëmundjamañifestohet në formën e një enterokoliti granulomatoz me zmadhim të nyjeve limfatike dhe enëve limfatikepërreth. Shenja tipike është diareja e vazhdueshme dhe humbja progressive e peshës trupore. Paratuberkulozi është i përhapur në të gjithë botën. Njerëzit mund të infektohen nëpërmjet mishit dhe qumshtit nga kafshët e infektuara, por edhe ambientit si një burim sekondar i ekspozimit ndaj Mycobacterium paratuberculosis. Metodatmolekulare, PCR mundësohen dhe kanë një vlerë mjaft të madhe në diagnozën e hershme të sëmundjes

Fashioloza në gjedhë dhe në dhen

Fashioloza apo siç quhet ndryshe dhe flutura e mëlçisë, është një sëmundje parazitare që shkaktohet nga Fasciola hepatica, një parazit që lokalizohet në kanalet biliare të mëlçisë, në shumë specje, si gjedhë, të imta, kuaj dhe njerëz. Shenjat klinike në gjedhë dhe të imta janë anemia dhe enteritis (diareja) çka çojnë në dobësim deri kasheksi të kafshës. Por shpesh sëmundja ka një zhvillim të ngadaltë, në formën e një sëmundje kronike. Në viça apo në qingja mund të shkaktojë një infektion akut në formën e një pneumonie hemorragjike si rezultat i migrimit masiv të larvave të parazitit, ose në formën e një toksinfeksioni të shkaktuar nga hepatiti nekrotik (infektion dytësor



I shkaktuar nga Klostridët) dhe nga absesi i mëlçisë (nga *Corynebacterium*). Dëmi ekonomik i shkaktuar nga Fashioloza po bëhet gjithnjë dhe më i madh, pasi sëmundja zhvillohet shuë ngadalë dhe nuk kapet që në fillim, si rrjedhojë janë shtuar shumë rastet e ngordhjeve. Me anë të kësaj metode serologjike bëhet I mundur identifikimi i antittrupave në gjakun e kafshës, zbulim i hershëm, mjekim I tufës, duke evituar ose minimizur ngordhjet.

Agalaksia në dhen dhe në dhi.

Agalaksia (*Mykoplazmoza* është një sëmundje epidemike shumë e përhapur në rajonin e mesdheut, kryesisht në dhen dhe në dhi. Shenjat klinike kryesore janë Mastiti i shoqëruar me një rënie të theksuar të prodhimit të qumstit, artrite si dhe kerato- konjuktivit deri në qorrim të kafshës së prekur. Përhapja në tufë është shumë e shpejtë. Zbulimi i antittrupave në serum in e kafshëve të sëmura, bën të mundur një diagnozë të shpejtë të sëmundjes dhe marrjen e masave të menjëhershme në tufë.

Klamidioza në të imta dhe në gjedhë

Klamidioza apo Aborti enzotik shkaktuar nga *Chlamydia* abortus është një sëmundje që kryesisht prek delet dhe dhitë dhe më pak gjedhët. Kjo sëmundje shkakton dëme të konsiderueshme në riprodhim veçanërisht në ato tufa ku dendësia e kafshëve është e lartë, sidomos para shkëputjes së qingjave. Kafshët e infektuara me Klamidiozë nuk shfaqin shenja klinike të sëmundjes përpara se të abortojnë. Sëmundja fillon kur infeksioni prek placenten duke dhënë një reaktion inflamativ shumë të përhapur deri në nekrozë të indeve. Kafshët e infektuara e sekretojnë shkaktarin në ambjen 2 javë para deri 2 javë pas abortit. Kjo shpjegon edhe numrin e lartë të aborteve në tufat e infektuara rishtas., pasi ndjeshmëria ndaj infeksionit është e lidhur me gjendjen fiziologjike të kafshës. Suksesi në çrrënjosjen e sëmundjes lidhet me cilësinë dhe efektivitetin e diagnozës. Izolimi i shkaktarit është shumë i vështirë dhe kërkon shumë kohë, prandaj diagnoza bazohet kryesisht në metodat serologjike.